



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:072425
Datë: 27.07.2022
Numri i dokumentit: 03271532

C.nr.209/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Feim Bytyqi, në çështjen juridike të paditësit Q. G. nga Suhareka të cilën me autorizim e përfaqëson zyra e avokatisë K. F. dhe F. G. me seli në Prishtinë kundër të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën e përfaqëson A. B. me aktemërim, me objekt kontesti padi për pagesën e shujtave ditore, me vlerë të kontestit 1000 euro, në seancën gjyqësore të mbajtur në praninë e Av.F. G. i autorizuar i paditëses dhe të përfaqësuesit të të paditurës me dt.21.07.2022 mori, ndërsa me dt.27.07.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit Q. G. nga Suhareka mësimdhënës në SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës.

DETYROHET e paditura Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit në emër të pagesës së shujtave ditore për **888** ditë pune t’ia paguaj shumën prej **1776** euro me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dh. Pretendimet e të autorizuarit të paditurës se kërkesëpadia për shujta për vitin 2021 dhe 2022 te refuzohet pasi që është në kundërshtim me nenin 45 të Kontratës kolektive nr. 105 të dt. 22.01.2021 gjykata e refuzoi si te pa bazë, pasi që dispozita e nenit 45 të kësaj kontrate ka karakter këshillues, ndihmues për mënyrën e planifikimit me kohë të buxhetit dhe koston financiare për detyrimet që lindin nga neni 35 i kontratës Kolektive dhe as se si nuk është detyrues dhe pengues që kërkesat e arritura të paguhet nga e paditura. unshëm.

OBLIGOHET e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 260 euro (dyqindegjashtëdhjetë euro), brenda afatit të paraparë si në pikën I të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Q. G. nga Suhareka mësimdhënës në SHFMU “.. N.” në fshatin D. Komuna e Suharekës përmes të autorizuarve të saj zyra e avokatisë K. F. dhe F. G. me seli në Prishtinë, pranë kësaj Gjykate me datë 19.06.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Suharekës –

Drejtoria Komunale e Arsimit për pagesën e shujtave ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

E paditura ka paraqitur përgjigje në padi nuk e ka kontestuar bazën e padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin e shujtave ditore dhe i ka propozuar gjykatës që e njëjta të aprovohet pjesërisht si e bazuar për tri vitet e fundit nga parashtrimi i padisë ndërsa për pjesën tjetër nga data 18.04.2017 deri me dt.19.06.2017 të refuzohet për shkak të parashkrimit.

I autorizuar i paditëses Av.F. G. në seancë ka deklaruar se e bën precizimin e kërkesëpadisë sa i përket kompensimit të shujtave ditore duke shtuar edhe periudhën nga data 26.02.2020 deri me datë 26.06.2022 gjegjësisht edhe për 361 ditë pune apo në total 888 ditë apo shuma në euro në vlerë 1776 euro, tërhiqem nga parashtrësia e dt.08.10.2021. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave u vërtetua në tërësi kërkesëpadija e paditësit si nga baza juridike ashtu edhe nga lartësia e saj andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar në shumën e precizuara si më lart me kamatë ligjore 8 % nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive. Njëherit ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë 104 euro, për taksën gjyqësore 21 euro dhe për një seancë të mbajtur 135 euro apo në shumë të përgjithshme prej 260 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës me akt emërim A. B. në seancë përgatitore ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija bazën juridike e ka në kontratën kolektive, pas administrimit të provave kërkoj nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj pjesërisht dhe atë për periudhën 2018 – 2019 e deri me 31.12.2021 ndërsa për periudhën 2022 ta refuzoj dhe atë për 111 ditë pune në bazë të nenit 45 të kontratës së re kolektive. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pasi u administruan të gjitha provat vlerësoj dhe konsideroj që padia dhe kërkesëpadija bazën e saj ka te kontrata kolektive dhe ka mbetur në tërësi si në deklarinë në fjalën hyrëse duke shtuar që është fakt i njohur se vërtetimet e sjellura për ditët e punës nga drejtorët e shkollave bazohen në kalendar shkollor

Gjykata më qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë ka bërë shiqimin në: listën e pagave për paditësin, kontratën e punës për paditësin nr.61/17 të dt.04.09.2017, vërtetimin nr.106/22 dhe vërtetimin për pagën për paditësin.

Gjykata pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Me shiqimin dhe leximin në vërtetimin për vijueshmërinë në punë për paditësin Qerim Gallapeni të lëshuar nga SHFMU “.. N.” me numër të protokollit 106/2022 të dt.13.07.2022 u vërtetua se paditësi nga data 18.04.2017 deri me datë 26.06.2020 për vitet 2017-2020 i ka gjithsejtë 888 ditë përvojë pune gjegjësisht për vitin shkollor 2016-2017 ka 42 ditë përvojë pune, 2017-2018 ka 185 ditë përvojë pune, për vitin shkollor 2018-2019 ka 185 ditë përvojë pune dhe për vitin shkollor 2019-2020 ka 115 ditë përvojë pune, për vitin shkollor 2020-2021 ka 178 ditë përvojë pune dhe për vitin shkollor 2021-2022 ka 183 ditë përvojë pune.

Nga leximi i kontratës së punës me nr. protokollit 61/17 të dt.04.09.2015 të lidhur ndërmjet DKA Suharekë dhe punëtorit Q. G. u vërtetua se paditësi është i sistemuar në punë si punëtor ndihmës

në SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës nga leximi në listën e pagave u vërtetua se paditësi ka pagën mujore 262 euro në muaj.

Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestuese se paditësi punon te e paditura gjegjësisht në SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës dhe ka përvojën e punës si dhe ditët e punës nga dt 18.04.2017 deri me datë 26.06.2022 siç u cek më lart. Njëherit nuk është kontestuese se e paditura është e obliguar që t’ia paguaj paditësit shumë prej dy euro në emër të shujtës ditore për çdo ditë të punës sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është vetëm çështja se sa ditë përvojë pune ka paditësi në SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës për të cilat duhet t’i paguhet shujta ditore.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga administrimi i provave të cituara më lart.

Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, vendosi që të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia falur besimin vërtetimit për përvojën e punës për paditësin të lëshuar nga drejtori i shkollës SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës, precizimit të kërkesëpadiës në seancë me dt.21.07.2022, kontratës së punës, listës së pagave dhe deklarimit të palëve ndërgjyqëse.

Aprovimin e kërkesëpadiës Gjykata e bazoi në kontratën kolektive konkretisht neni 35 paragrafi 7 në të cilën është paraparë që *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Gjykata me aprovimin e kërkesëpadiës së paditëses dhe lartësinë e të njëjtës pati parasysh faktin se paditësit nuk i janë paguar shujtat ditore për ditët e përvojës së punës e cila çështje është e rregulluar me Kontratën Kolektive të Arsimit Para universitar të përshkruar si më lart.

Në bazë të lartcekurave Gjykata ka vërtetuar se e paditura është e obliguar ndaj paditëses konform nenit 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 që t’ia paguaj shujtat ditore për ditët e përvojës së punës të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me kërkesën e aprovuar për shumë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, Gjykata përfundimisht është e mendimit se shuma është adekuate duke marr parasysh përvojën e punës gjegjësisht ditët e punës përgjatë viteve shkollore siç janë përshkruar edhe në vërtetimin e lëshuar nga drejtori i shkollës SHFMU “.. N.” në D. Komuna e Suharekës.

Pretendimet e të autorizuarit të paditurës se kërkesëpadija për shujta për vitin 2021 dhe 2022 te refuzohet pasi që është në kundërshtim me nenin 45 te Kontratës kolektive nr. 105 të dt. 22.01.2021 gjykata e refuzoi si te pa bazë, pasi që dispozita e nenit 45 të kësaj kontrate ka karakter këshillues , ndihmues për mënyrën e planifikimit me kohë të bugjetit dhe kosos financiare per detyrimet qe lindin nga neni 35 i kontratës Kolektive dhe as se si nuk është detyrues dhe pengues që kërkesat e arritura të paguhen nga e paditura.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksime të tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për përfaqësim në seancë shumën prej 135 euro dhe shumën prej 21 euro në emër të taksës gjyqësore apo në shumë të përgjithshme prej 260 euro (dyqindegjashtëdhjetë euro).

Gjykata Aktgjykimin e mori në kuptim të nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.209/2020 dt.27.07.2022**

Bashk.profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.